

VENDIM
Nr.38, datë 22.1.2004

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E BORDIT TË KËSHILLTARËVE,
PËR ZBATIMIN E KONVENTËS "PËR NDALIMIN E ZHVILLIMIT, TË PRODHIMIT,
MAGAZINIMIT DHE PËRDORIMIT TË ARMËVE KIMIKE DHE PËR SHKATËRRIMIN E
TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.9092, datë 3.7.2003 "Për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Bordit të Këshilltarëve për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre", pranë Ministrit të Mbrojtjes (autoriteti shtetëror), i cili të ketë në përbërje si anëtarë nga një përfaqësues nga:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Rendit Publik;
- Ministria e Mjedisit.

Përfaqësuesit e ministrive, anëtarë të Bordit të Këshilltarëve, të jenë në nivel drejtor drejtorie.

2. Ky Bord funksionon si organ kolegjal, në mbështetje të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

3. Bordi i Këshilltarëve mbledhet, si rregull, me kërkesën e autoritetit shtetëror ose të shumicës së anëtarëve të Bordit. Kur mbledhja thirret nga autoriteti shtetëror, njoftimi përmban rendin e ditës dhe materialet për të cilat kërkohet mendim, të cilat u dërgohen anëtarëve të Bordit të këshilltarëve të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

4. Bordi i Këshilltarëve i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve. Për shkaqe objektive, mbledhjet e Bordit të Këshilltarëve shtyhen, por jo më vonë se 15 ditë nga data e caktuar.

5. Bordi i Këshilltarëve, si një organ këshillues, ka detyrat e mëposhtme:

a) Bashkëpunon me institucionet shkencore: Universitetin e Tiranës (Fakultetin e Shkencave të Natyrës), Universitetin Politeknik, Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, shoqatat e industrisë kimike dhe me organizma e specialistë të fushës së kimisë, për asistencë teknike dhe për hartimin e politikave të ndryshme, në zbatim të Konventës.

b) Për çështje që ndikojnë në sigurinë kombëtare, i propozon autoritetit shtetëror të vërë në dijeni Kuvendin, Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin.

c) I sugjeron dhe i rekomandon autoritetit shtetëror krijimin e grupeve të përbashkëta të punës për studimin dhe vlerësimin e problemeve teknike e shkencore në zbatim të Konventës.

ç) Shqyrton dhe jep mendim për udhëzimet e përbashkëta me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Mjedisit.

d) I propozon autoritetit shtetëror marrjen e masave të përkohshme apo të përhershme për zbatimin e Konventës.

dh) Nxist zhvillimin e njohurive shkencore e teknologjike në fushën e industrisë kimike, të bujqësisë, kërkimeve shkencore, mjekësisë, farmaceutikës apo për qëllime të tjera që lidhen me Konventën "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre".

e) Harton politika për zbatimin e Konventës, duke shmangur pengesat e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik dhe nxit bashkëpunimin ndërkombëtar për veprimtari kimike, që nuk ndalohen nga kjo Konventë, përfshi shkëmbimin e të dhënave teknike e shkencore në nivel ndërkombëtar dhe të pajisjeve për prodhimin dhe përdorimin e kimikateve.

6. Shpërblimi i anëtarëve të bordit të këshilltarëve për pjesëmarrje në mbledhje të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxhetet vjetore të ministrive të përfaqësuara në Bord.

8. Ngarkohen ministritë e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano